



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 153, Datë 25/10/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 90, datë 26.07.2019, e znj. I. H., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, nga ana e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”¹.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se në datën 05.03.2011, bashkëshorti i ankueses, z. V. H. ka humbur jetën në krye të detyrës si polic i forcave të rendit, gjatë një konflikti ndërmjet tifozëve në Stadiumin “Loni Papuçiu”, Fier. Që prej vitit 2011, znj. I. H. jeton dhe kujdeset e vetme për 3 fëmijët e saj, në mungesë të babait të tyre. Me Vendimin nr. 193, datë 25.03.2011, të Këshillit të Komunës Grecalli, z. V. H. iu dha titulli “Nderi i Komunës” (pas vdekjes) me motivacion: “*Biri i fshatit Grecalli, prind e qytetar shembullor, me marëdhënie korrekte në komunitet, i përkushtuar në punë e detyrë për zgjidhjen e shmangien e konflikteve, u nda nga jeta në krye të detyrës si polic i forcave të rendit, krenari e komunitetit që e rrethonte*”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KQSDA.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në vijim, me Vendimin nr. 14, datë 24.05.2017, të Këshillit të Qarkut Fier, u bë propozimi për shpalljen e z. V. P. H., Dëshmor i Atdheut. Vendimi i mësipërm, pas kryerjes së verifikimit të përputhshmërisë me ligjin nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore” nga ana e Prefektit të Qarkut Fier³, u dërgua nëpërmjet shkresës nr. 484/1, datë 12.09.2017, të Këshillit të Qarkut Fier pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Për sa më sipër, ankuesja sqaron se ka dërguar disa kërkesa pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, nëpërmjet së cilave kërkon të disponojë informacion mbi procedurat e ndjekura nga ky institucion dhe mbi fazën, në të cilën ndodhet praktika për bashkëshortin e saj.

Nëpërmjet shkresës nr. 258/1, datë 31.05.2018, Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” e ka informuar ankuesen se ky institucion e ka shtyrë marrjen e vendimit përfundimtar për arsye se propozimi nuk është shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Për plotësimin e mangësive në dokumentacion, ky institucion ka kërkuar nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, si dhe nga Prokuroria dhe Gjykata e rrethit gjyqësor Fier, dokumente që japin informacion mbi rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, V. H. Njëkohësisht, Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” ka kërkuar dokumentacion plotësues edhe nga ankuesja, dokumentacion, i cili i është dërguar zyrtarisht nga kjo e fundit.

Znj. I. H. pretendon se edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga shkresa e fundit e dërguar nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, si dhe pothuajse 2 vjet nga dërgimi i propozimit të Këshillit të Qarkut Fier, për shpalljen e z. V. H. “Dëshmor i Atdheut”, Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” nuk është shprehur ende me vendim mbi statusin e bashkëshortit të saj.

Për sa më sipër, znj. I. H. pretendon diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, nga ana e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 90, datë 26.07.2019, e znj. I. H., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë

³ Referuar shkresës nr. 520/1, datë 05.06.2017, të Prefektit të Qarkut Fier drejtuar Kryetarit të Këshillit të Qarkut Fier.

04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, me shkresën nr. 1168/1, datë 31.07.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

1. Informacion i hollësishëm mbi hapat e ndjekura mbi praktikën e z. V. H., nga momenti i dërgimit të shkresës nr. 484/1, datë 12.09.2017, të Këshillit të Qarkut Fier pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”;
2. Kopje e praktikës së z. V. H., si dhe të përgjigjeve të dërguara nga institucionet e cituara në shkresën nr. 258/1, datë 31.05.2018, e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”;
3. Informacion nëse për rastin e z. V. H., plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, për përfitim të statusit “Dëshmor i Atdheut”;
4. Informacion mbi arsyet e kalimit të afatit ligjor, për miratimin e vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” mbi rastin e z. V. H..

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe ankueses.

1. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” nuk i ktheu përgjigje Komisionerit brenda afatit ligjor;
2. Në këto kushte, KMD iu drejtua sërish institucionit të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 1168/2, datë 20.09.2019, ku i bën kujtesë për t’i kthyer përgjigje shkresës paraardhëse.
3. Në përgjigje të të dy shkresave të KMD-së, Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” dërgoi shkresën nr. 141/1, datë 03.10.2019, nëpërmjet së cilës informon si vijon:

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Lidhur me çështjen e parë, të parashtruar nga KMD, KQSDA informon se propozimi i Këshillit të Qarkut Fier për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të z. V. H., është regjistruar pranë Sekretarisë së Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” në datën 20.09.2017. Stafi teknik i KQSDA, fillimisht ka kryer inventarin e dokumentacionit të ardhur, si dhe verifikimin e përbushjes së kritereve formale ligjore të tyre. Për sa më sipër, Sekretariati ka konstatuar se dokumentacioni i dërguar nuk plotësonte kriteret formale të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, si vijojnë: Dokumentacioni i dërguar ishte fotokopje, propozimi nuk ishte i shoqëruar me motivacionin përkatës, (në referencë të nenit 2 të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Statusi i dëshmorit të Atdheut”, (shfuqizuar ne shkurt 2019), dokumentacioni shoqërues i ankesës ishte i pashoqëruar me dokumente vërtetuese të formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe përcaktuar në nenin 3, të ligjit të sipërpërmendur (i shfuqizuar), nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, si dhe shkronjës a), të pikës 2, të Vendimit nr. 151, datë 25.04.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin Dëshmor i Atdheut” (i ndryshuar), si dhe Udhëzimi nr. 382, datë 10.06.2003, të Kryetarit të KQSDA-së, “Për disa shtesa dhe përmirësime në Udhëzimin nr. 1803, datë 10.06.2002, “Për zbatimin e Vendimit nr. 151, datë 25.04.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” (i ndryshuar).

Mbështetur në rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij mbi procedurën e komunikimit me subjektet propozuese (Këshillin e Qarkut apo Prefektin), në takimin e zhvilluar me përgjegjësit e zyrës së sekretarisë së Këshillit të Qarkut Fier, në muajin tetor 2017, ku u bisedua mbi problemet e korrespondencës ndërmjet Këshillit të Qarkut Fier dhe Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, ndërmjet të tjerave, Stafi teknik i këtij Komisioni kërkoi të administronte dokumentacionin origjinal të përgatitur nga Komisioni Vendor dhe Këshilli i Qarkut Fier, për propozimin e shpalljes Dëshmor të Atdheut të shtetasit V. H.. Këshillit të Qarkut Fier iu kërkua që të dërgonin me postë, dokumentacionin e munguar, sikurse përcaktohet në aktet nënligjore të sipërcituara.

Gjatë takimit, punonjësit e Këshillit të Qarkut Fier nuk mundën të gjenin dhe dorëzonin kopjen origjinale të dokumentacionit. Në këto kushte, u ra dakord që dokumentacioni, i cili ishte dërguar pranë KQSDA-së të vulosej në çdo fletë me vulën e sekretarisë së Këshillit të Qarkut, si dhe në vijim të dërgoheshin dokumentet e munguara. Dokumentet e kërkuara nga Stafi Teknik i KQSDA-së nuk u dërguan në vijim nga Këshilli i Qarkut Fier.

Stafi Teknik i KQSDA-së, në zbatim të detyrës së ngarkuar nga KQSDA-së, në mbledhjen e muajit maj 2017, për përfshirjen në procedurën administrative të shqyrtimit nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, të disa propozimeve për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, për disa punonjës të Policisë së Shtetit dhe disa ushtarakë të Forcave të Armatosura, të cilët kishin humbur jetën në krye të detyrës, në rrethana dhe për shkaqe që nuk parashikoheshin në

nenin 2 të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, (i ndryshuar) si dhe nisur nga qëllimi për të mos dëmtuar interesat ligjore të subjekteve kërkuese (familjeve të të ndjerëve), vendosi që të mos e kthejë dokumentacionin e parregullt pranë subjekteve propozuese, por t’i plotësojë vetë dosjet e personave të propozuar për shpalljen Dëshmor i Atdheut, me dokumentet arkivore të organeve shtetërore, të cilat kishin dijeni apo kishin zhvilluar hetime për vdekjen e punonjësit të policisë apo ushtarakut të FA. Kjo u krye me qëllim përfshirjen e propozimeve në procedurën administrative të shqyrtimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Në këtë kuadër, me synim plotësimin me dokumente arkivore shtesë të dosjes së z. V. H., stafi teknik kërkoi nga organet shtetërore, dokumente arkivore me të dhënat për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së punonjësit të policisë.

Pas plotësimit me dokumente shtesë të dërguara nga Drejtoria e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria Vendore e Policisë së Fierit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Gjykata e Shkallës së Parë Fier, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier, si dhe nga shtetësja I. H., propozimi i Këshillit të Qarkut Fier, për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të shtetasit Vasil Pandeli Hysi u përfshi në procedurën administrative të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, për t’u shqyrtuar në mbledhjen e tij të rradhës, të planifikuar pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për statusin e dëshmorit të ardheut.

Me miratimin nga Kuvendi, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, hyrjes së tij në fuqi (në muajin shkurt 2019) dhe në pritje të miratimit nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore në zbatim këtij ligji, propozimi i Këshillit të Qarkut Fier, për shpallje “Dëshmor i Atdheut” të ish-punonjësit të Policisë së Shtetit Vasil Pandeli Hysi, bashkë me disa propozime të tjera të bëra në vitet 2017, 2018 dhe 2019, për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të disa punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të disa ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të cilët kanë humbur jetën në krye të detyrës, në rrethana dhe shkaqe, që nuk përfshihen në kriteret e përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 109/2018 “*Për statusin e dëshmorit të atdheut*”, si dhe për parregullsi të tjera, janë përfshirë në procedurën e marrjes së vendimit nga KQSDA, në mbledhjen e saj të radhës, që është planifikuar të zhvillohet në muajin nëntor 2019.

Në lidhje me kalimin e afateve ligjore për shqyrtimin e dosjes së z. V. H. pranë KQSDA-së, në shkresën e këtij institucioni sqarohet se kërkuesja, që është bashkëshortja e të ndjerit ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Mbështetur në nenin 10, të ligjit nr. 109/2018 “Për Statusin Dëshmor i Atdheut” KQSDA është organ kolegjal, i përhershëm dhe i pavarur, i cili është autoriteti që shpall ose njeh statusin

“Dëshmor i Atdheut”, në bazë të propozimit të bërë nga Këshilli i Qarkut, Këshilli Bashkiak, Prefekti ose Ministri përkatës, për subjektet nën fushën e tyre të përgjegjësisë. Ligji i sipërpërmendur nuk përcakton organ më të lartë për ushtrimin e mjeteve ligjore administrative ndaj vendimit apo mosveprimit administrativ të KQSDA-së. Ligji, gjithashtu, nuk parashikon ushtrimin e mjeteve ligjore administrative ndaj vendimit të këtij kolegji apo ndaj mosveprimit administrativ të KQSDA-së, por vetëm ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative (neni 23).

KQSDA e ka vënë në dijeni shtetasen I. H., mbi ecurinë e procedurës për shqyrtimin e propozimit për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të bashkëshortit të saj, si dhe arsyet e mos shqyrtimit në afat të propozimit nga Komisioni Qendror (arsyeja: përfshirja në procedurën e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit pas plotësimit të propozimit me dokumentacionin, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore për statusin e Dëshmorit të Atdheut.)

Në shkresën e KQSDA-së sqarohet gjithashtu fakti se objekti i punës së këtij institucioni është shqyrtimi i dokumentacionit të lëshuar nga organet publike, të krijuara në kohën e ngjarjes së humbjes së jetës së personit, të propozuar për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, ku jepen të dhëna për identitetin, veprimtarinë e tij, si dhe rrethanat e shkaqet e humbjes së jetës së të ndjerit dhe nuk shqyrton gjendjen e subjektit kërkues, që ka depozituar kërkesë pranë Këshillit të Qarkut apo Këshillit Bashkiak ose prefektit. Subjekti kërkues mund të jetë: përfaqësues i familjes së personit të propozuar për statusin “Dëshmor i Atdheut”, drejtues i organeve shtetërore apo përfaqësues i shoqërisë civile.

Kur propozimi i bërë nga subjekti propozues, për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, nuk shqyrtohet brenda afatit ligjor nga KQSDA, ka të bëjë vetëm me arsye objektive, që lidhen me mangësitë e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues dhe propozues, për rastin objekt-propozim, ose kur ka shkaqe objektive, që konsistojnë në mos mbledhjen e KQSDA-së. Ndërkohë që, në rastet kur KQSDA merr një vendim përfundimtar, që nuk përkon me dëshirën (kërkesën) e subjektit kërkues ose sipas propozimit të bërë, një vendim i tillë justifikohet vetëm me mosplotësimin e kritereve për shpalljen apo njohjen e statusit të dëshmorit të atdheut, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

Lidhur me çështjen e tretë të parashtruar nga KMD në shkresën nr. 1168/1, datë 31.07.2019, KQSDA sqaron se Stafi i tij Teknik mbështetur në parashikimet e dispozitave përkatëse të akteve ligjore dhe nënligjore të përmendura edhe më sipër shprehet: “Bazuar në dokumentet e paraqitura, propozimi i Këshillit të Qarkut Fier, për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të shtetasit V. H. nuk është shoqëruar me motivacionin përkatës sipas kritereve të përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Nga vlerësimi i dokumenteve arkivore

shitesë të ardhura pranë KQSDA nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe organeve të drejtësisë (prokurori, gjykatë), bazuar në kërkesën e Komisionit Qendror, rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës në krye të detyrës së ish-punonjësit të Policisë së Shtetit Vasil Pandeli Hysi nuk përmbajnë kritere të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 109/2019 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”, në vitin 2017, vendosi që propozimet e bëra dhe ato që do të bëhen në vazhdim, për rastet e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të cilët kanë humbur jetën në krye të detyrës, në rrethana dhe për shkaqe, të cilat nuk janë përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, kur janë të plotësuar me dokumentacionin e plotë, të lëshuar nga strukturat e këtyre institucioneve (Policia e Shtetit dhe FA), si dhe të organeve të drejtësisë (prokurori, gjykatë), që japin të dhëna të hollësishme dhe të qarta, për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së tyre, të futen në procedurën e shqyrtimit nga KQSDA, i cili vendos shpalljen ose jo “Dëshmor të Atdheut”, të personave të propozuar.

Në shkresën e KQSDA-së theksohet fakti se dhe në rastin e shtetasit V. H. do të jetë ky kolegji që mbështetur në vlerësimin e shqyrtimit të dokumentacionit të siguruar, si dhe të relacionit të paraqitur nga Stafi Teknik, do të marrë vendimin përfundimtar.

Në lidhje me çështjen e kalimit të afatit për marrjen e vendimit të KQSDA-së mbi rastin e Z. V. H., në shkresën e këtij institucioni sqarohet se aktet ligjore dhe nënligjore për statusin e dëshmorit të atdheut përcaktojnë detyrimin e subjektit kërkues dhe të organit propozues që bashkë me kërkesën dhe propozimin për shpalljen dëshmor të atdheut të një personi, të paraqesin pranë KQSDA-së edhe dokumente arkivore të krijuara nga organet publike në kohën e ngjarjes, të cilat japin të dhëna për rrethanat dhe shkaqet e humbjes së jetës së personit, ose që vërtetojnë rënien në krye të detyrës, sipas kritereve dhe rrethanave të parashikuara në nenin 5 të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Paraqitja e plotë e dokumenteve vërtetuese, që duhet të shoqërojnë propozimin e organit propozues dhe kërkesën e subjektit kërkues janë kusht për fillimin e procedurës administrative nga KQSDA. Afati për përfundimin e procedurës administrative të KQSDA-së fillon nga data e paraqitjes së plotë të dokumenteve vërtetuese, që do të duhet të shoqërojnë çdo propozim apo kërkesë për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”.

Dokumentacioni i plotë për rastin e propozimit për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” të shtetasit V. H. është plotësuar në korrik të vitit 2018, pas kërkesave të KQSDA-së dhe stafit teknik të tij.

Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” mblidhet me kërkesën e Kryetarit të këtij kolegji. Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2017, ky komision nuk është mbledhur për shkak të

periudhës së kostituimit të qeverisë, pas zgjedhjeve të përgjithshme të zhvilluara në korrik të vitit 2017 dhe e mos plotësimit të Komisionit Qendror⁵, me anëtarët e rinj.

Në shkresë theksohet fakti se gjatë vitit 2018, KQSDA nuk ka zhvilluar mbledhje për shqyrtimin e propozimeve të ardhura për statusin e dëshmorit të atdheut, për arsye të angazhimit me procedurat e përgatitjes së draftit të projektligjit të ri për statusin e Dëshmorit të Atdheut dhe në vijim në pritje të miratimit nga Kuvendi dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri në shkurt 2019. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe në pritje të miratimit nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore në zbatim të tij, KQSDA është njoftuar për mbledhje nga Kryetari, vetëm për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme të ndodhura në vitin 2019 (2 ushtarakët e rënë në misionet jashtë vendit) dhe për marrjen e vendimeve përfundimtare për propozimet e shqyrtuara nga Komisioni në mbledhjet para vitit 2017, për të cilat ishte vendosur shtyrja e marrjes së vendimeve përfundimtare për plotësimin e parregullsive dhe të dokumentacionit përkatës.

Propozimet e ardhura gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2017, vitit 2018 si dhe ato të 6-mujorit të parë të vitit 2019 janë planifikuar të shqyrtohen në mbledhjen e rradhës së KQSDA-së që pritet të zhvillohet në muajin nëntor 2019.

Bashkëlidhur shkresës së KQSDA-së janë dërguar shkresat dhe praktikat e kërkuara nga Komisioneri.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 90, datë 26.07.2019, e znj. I. H., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 90, datë 26.07.2019, e znj. I. H., pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, nga ana e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Referuar akteve të depozituara në cilësinë e provës nga ankuesja dhe KQSDA, rezulton se bashkëshorti i znj. I. H. ka qenë punonjës policie pranë Komisarariatit të Policisë Fier dhe ka humbur jetën në krye të detyrës në datën 05.03.2011, ora 15.30.

⁵ KQSDA për bëhet nga Ministri i Mbrojtjes në cilësinë e Kryetarit, 4 zëvendësministra të minisrive të ndryshme dhe 2 përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve.

Mbështetur në vendimin nr. 62-2015-4029 (1254), datë 02.10.2015, e gjykatës së rrethit gjyqësor Fier rezulton se z. V. H., punonjës policie në shërbim, ka gjetur vdekjen në mënyrë të papritur në Stadiumin e futbollit “Loni Papuçiu”, Fier. Në referencë të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr. 14, datë 05.03.2011 ka rezultuar se z. V. H. ka ndërruar jetë si pasojë e infarktut të miokardit. Nëpërmjet vendimit të sipërpërmendur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të humbjes së jetës së të ndjerit V. P. H., punonjës policie në Komisaratin e Policisë Fier, në krye të detyrës për ruajtjen e rendit në stadiumin “Loni Papuçiu” Fier, në datën 05.03.2011, ora 15.30.

Organet e pushtetit vendor i kanë akorduar nderin dhe respektin e duhur Z. Hysi, me vendime të veçanta. Me Vendimin nr. 40, datë 29.05.2015 e Këshillit Bashkiak Fier “Për ngritjen e memorialit në stadiumin “Loni Papuçiu”, për të ndjerin V. H. u ngrit një memorial në vendin, ku kishte humbur jetën. Ndërkohë që, edhe me Vendimin nr. 193, datë 25.03.2011, e Këshillit të ish-Komunës Grecalli, shtetasit V. H. iu dha titull nderi.

Në referencë të nenit 3, paragrafi 3 dhe nenit 5 të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, (i ndryshuar)⁶, bashkëshortja e të ndjerit V. H. ka depozituar kërkesën e saj nr. 484, datë 20.04.2017, pranë Kryetarit të Qarkut Fier, ku kërkon që të propozohet shpallja Dëshmor i Atdheut, të bashkëshortit të saj.

Në vijim, me Vendimin nr. 14, datë 24.05.2017, e Këshillit të Qarkut Fier është kryer propozimi për Komisionin Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut, me qëllim shpalljen e z. V. H. “Dëshmor i Atdheut”. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, ky vendim iu dërgua për verifikim ligjshmërie Prefektit të Qarkut Fier, i cili nëpërmjet shkresës nr. 520/1, datë 05.06.2017, ka konfirmuar ligjshmërinë e vendimit nr. 14, datë 24.05.2017, të Këshillit të Qarkut Fier.

Nëpërmjet shkresës nr. 484/1, datë 12.09.2017, së Këshillit i Qarkut Fier, Komisionit Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut iu dërgua praktika e përbërë nga aktet e sipërpërmendura, nëpërmjet se cilave propozohet miratimi i statusit “Dëshmor i Atdheut” për z. V. H.. Sikurse konfirmohet edhe nga shkresa nr.141/1, datë 03.10.2019 e KQSDA-së, praktika e z. V. H. është regjistruar pranë këtij Komisioni në datën **20.09.2017**.

Në momentin e depozitimit të praktikës së mësipërme për z. V. H., pranë Komisionit Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut ka qenë ende në fuqi ligji nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin

⁶ Ky ligj aktualisht është i shfuqizuar.

Dëshmor i Atdheut”, (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të cilat janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi në muajin shkurt 2019, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”.

Për shqyrtimin e kësaj ankese, KMD ka analizuar përmbajtjen e ligjit, që ka qenë në fuqi në momentin e depozitimit të praktikës së Z. Hysi pranë KQSDA.

Në nenin 4, paragrafi 3, të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, (i ndryshuar dhe shfuqizuar prej muajit shkurt 2019) parashikohet: *“Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, për ushtrimin e përgjegjësive të caktuara në ligj, mbështetet nga një staf teknik. Këshilli i Ministrave përcakton organin e linjës, pranë të cilit funksionon ky staf. Përgjegjësi i stafit teknik ushtron funksionet e sekretarit të Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Stafi teknik ka përgjegjësi që, brenda 45 ditëve nga afati i mbërritjes së propozimit, të verifikojë dokumentacionin, sipas nenit 3 të këtij ligji, të hartojë relacionin, projektaktin, si dhe projektin e rendit të ditës dhe t’ia përcjellë ato kryetarit. Kryetari i Komisionit, sipas dokumentacionit të dërguar nga stafi teknik, cakton rendin e ditës. Çdo propozim përfshihet në rendin e ditës dhe shqyrtohet në Komision brenda 3 muajve nga afati i dorëzimit të praktikës së plotë nga stafi teknik.”*

Kur kanë kaluar 3 muaj, por kërkesa nuk është shqyrtuar sipas këtij ligji, kërkuesi ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës të vendosë detyrimin ndaj Kryetarit të Komisionit, për të përfshirë kërkesën menjëherë në mbledhjen më të parë të Komisionit. Gjykata, brenda 10 ditëve, shqyrton kërkesën dhe jep vendim për çështjen.”

Për sa më sipër, rezulton se megjithëse kanë kaluar 2 vjet nga momenti i depozitimit të praktikës, ku propozohet shpallja e z. V. H., Dëshmor i Atdheut, KQSDA nuk është shprehur me vendim mbi këtë rast. Ankuesja I. H. nuk e ka ankimuar në gjykatën kompetente tejkalimin e afatit ligjor nga ana e këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në referencë të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, (i ndryshuar dhe aktualisht i shfuqizuar) dhe përkatësisht në Vendimin nr. 151, datë 25.04.2002, e Këshillit të Ministrave, “Për statusin Dëshmor i Atdheut” (i ndryshuar) dhe në Udhëzimin nr. 1803, datë 10.06.2002, e Komisionit Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut “Për zbatimin e Vendimit nr. 151, datë 25.04.2002, të Këshillit të Ministrave,

“Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”⁷ (i ndryshuar) ku rezultojnë të jenë miratuar kriteret dhe dokumentet për njohjen e statusit të Dëshmorit të Atdheut, KQSDA ka theksuar faktin se dokumentacioni i depozituar nga Këshilli i Qarkut Fier nuk ka qenë i plotë dhe origjinal. Për këtë arsye, në pamundësi për ta siguruar këtë dokumentacion të plotë nga subjekti propozues, në vijim, Sekretariati Teknik i këtij Komisioni ka proceduar kryesisht duke iu dërguar shkresa zyrtare institucioneve përgjegjëse për plotësimin e praktikës së z. V. H..

Për sa më sipër, referuar provave të depozituara nga KQSDA, rezulton se Sekretariati Teknik ka dërguar shkresa zyrtare pranë Komisionit të Policisë Fier, Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së shtetit, Drejtorisë së Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Shkallës së Parë Fier, Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, si dhe znj. Lida Hysi, për plotësimin e dokumentacionit përkatës. Referuar përgjigjeve të dërguara nga institucionet e mësipërme rezulton se praktika e z. V. H. **është plotësuar në muajin korrik 2018.** Vetëm pas plotësimit të këtij dokumentacioni, Sekretariati Teknik ka proceduar mbi këtë praktikë, si dhe mbi disa praktika të tjera, të cilat kishin dokumentacion të mangët. Paraqitja e plotë e dokumenteve vërtetuese, që duhet të shoqërojnë propozimin e organit propozues dhe kërkesën e subjektit kërkues janë kusht për fillimin e procedurës administrative nga KQSDA. Afati për përfundimin e procedurës administrative të KQSDA-së fillon nga data e paraqitjes së plotë të dokumenteve vërtetuese, që do të duhet të shoqërojë çdo propozim apo kërkesë për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”.

Në kushtet kur, në bazë të nenit 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)⁸, KQSDA ka patur barrën e provës për të provuar se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të disfavorshme dhe të pabarabartë, në krahasim me individë apo grupe të tjerë individësh, që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme, ky Komision ka depozituar prova dhe fakte për të rrëzuar pretendimin e ankueses. Në referencë të shkresës nr. 141/1, datë 03.10.2019, së Sekretariatit Teknik të këtij Komisioni rezulton se gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2017, KQSDA nuk është mbledhur për

⁷Udhëzimi nr. 382, datë 10.06.2003, të Kryetarit të KQSDA-së, “Për disa shtesa dhe përmirësime në Udhëzimin nr. 1803, datë 10.06.2002, “Për zbatimin e Vendimit nr. 151, datë 25.04.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” (i ndryshuar).

Këto akte nënligjore aktualisht janë të shfuqizuara, pas shfuqizimit të të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, (i ndryshuar), pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”.

⁸ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

shkak të periudhës së kostituimit të qeverisë, pas zgjedhjeve të përgjithshme të zhvilluara në korrik, të vitit 2017 dhe si rrjedhojë dhe e mos plotësimit të Komisionit Qendror, me anëtarët e rinj. Në vijim, gjatë vitit 2018, KQSDA nuk ka zhvilluar mbledhje për shqyrtimin e propozimeve të ardhura për statusin e dëshmorit të atdheut, për arsye të angazhimit me procedurat e përgatitjes së draftit të projektligjit të ri për statusin e Dëshmorit të Atdheut dhe në vijim në pritje të miratimit nga Kuvendi dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri në shkurt 2019. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe në pritje të miratimit nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore në zbatim të tij, KQSDA është njoftuar për mbledhje nga Kryetari, vetëm për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme të ndodhura në vitin 2019 (2 ushtarakët e rënë në misionet jashtë vendit) dhe për marrjen e vendimeve përfundimtare për propozimet e shqyrtuara nga Komisioni në mbledhjet para vitit 2017, për të cilat ishte vendosur shtyerja e marrjes së vendimeve përfundimtare për plotësimin e parregullsive dhe të dokumentacionit përkatës.

Propozimet e ardhura gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2017, vitit 2018 si dhe ato të 6-mujorit të parë të vitit 2019 janë planifikuar të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së KQSDA-së që pritet të zhvillohet në muajin nëntor 2019.

Në këtë kontekst, KQSDA justifikon mosveprimin e tij ndaj praktikës së shtetasit V. H., së pari me mangësitë e dokumentacionit të paraqitur pranë saj nga subjekti propozues dhe së dyti si pasojë e mos mbledhjes së këtij Komisioni për një periudhë relativisht të gjatë.

Mbështetur në provat e depozituara, KMD ka konstatuar se praktika e të ndjerit V. H. është plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm në korrik 2018. Për sa më sipër, rezulton se nga muaji korrik 2018 e deri në muajin tetor 2019, KQSDA nuk ka proceduar me praktikën e z. Hysi. Mbështetur në parashikimin përkatës të nenit 4, paragrafi 3, të ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, “Për statusin Dëshmor i Atdheut”, (*i ndryshuar dhe shfuqizuar prej muajit shkurt 2019*), i cili ka qenë në fuqi përgjatë vitit 2018, çdo propozim përfshihet në rendin e ditës dhe shqyrtohet në KQSDA, brenda 3 muajve nga afati i dorëzimit të praktikës së plotë nga stafi teknik. Në referencë të këtij ligji, KQSDA duhet të ishte shprehur me vendim brenda muajit tetor 2018, mbi shpalljen ose jo të z. V. H., “Dëshmor i Atdheut”. Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se mbi praktikën e të ndjerit jo vetëm që nuk është vepruar brenda vitit 2018, por edhe përgjatë 9-mujorit të vitit 2019. Në referencë të nenit 10, pika 6, të ligjit nr. 109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, i cili ka hyrë në fuqi në muajin shkurt 2019, parashikohet se propozimet e dërguara nga këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë apo prefektët shqyrtohen nga Komisioni Qendror, brenda 3 muajve, nga afati i regjistrimit në sekretarinë e Komisionit Qendror. Komisioneri ka konstatuar se edhe parashikimi i kësaj dispozite nuk është zbatuar nga KQSDA, që justifikon mosveprimin e saj me faktin se nuk ka zhvilluar mbledhje për shqyrtimin e propozimeve të ardhura për statusin e dëshmorit të atdheut, për arsye të angazhimit me

procedurat e përgatitjes së draftit të projektligjit të ri për statusin e Dëshmorit të Atdheut dhe në vijim në pritje të miratimit nga Kuvendi dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri në shkurt 2019. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se një justifikim i tillë nuk mund të konsiderohet i ligjshëm, për sa kohë që ligji i sipërpërmendur shprehet në mënyrë të qartë, lidhur me afatet mbi trajtimin e propozimeve të dërguara nga këshillat bashkiakë apo prefektët.

Në këtë kontekst, në interpretim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se znj. I. H. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues nga KQSDA.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 90, datë 26.07.2019, e znj. I. H., pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, nga ana e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

1. “*Gjendja familjare*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, Komisioneri gjykon se “*gjendja familjare*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe në bazë të dokumentacionit të depozituar në cilësi prove, rezulton se ankuesja është e ve dhe kryefamiljare.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet

me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut” duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe trajtimin të pafavorshëm të tij.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore⁹, rezultoi se:

Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e KQSDA-së, pasi ky Komision nuk është shprehur me vendim mbi propozimin e Këshillit të Qarkut Fier për shpalljen “Dëshmor të Atdheut” të z. V. H..

Mbështetur në provat e administruara, Komisioneri ka konstatuar gjithashtu se, sikurse praktika e z. V. H., kanë mbetur të pashqyrtuara edhe praktika të tjera të depozituara pranë Sekretariatit Teknik të KQSDA-së gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2017, vitit 2018 si dhe ato të 6-mujorit të parë të vitit 2019. Për këto praktika është vendosur të shqyrtohen në mbledhjen e KQSDA-së, që do të zhvillohet në muajin nëntor 2019.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet gjendjes familjare të ankueses dhe mosveprimit të KQSDA-së, në lidhje me praktikën e z. V. H..

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk ka diskriminim të ankueses I. H., për shkak të gjendjes familjare.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- 1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. I. H., për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”.**

⁹ Referuar dokumentacionit të dërguar nga DPT me shkresën nr. 14615/1, datë 23.08.2019, lidhur me llojin e diplomave të 69 punonjësve të Sektorit të Monitorimit Territorial.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – të mira dhe shërbime
Shkak – gjendja familjare